



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Prishtinës
Opština Priština –Municipality of Prishtina

KRYETARI I KRYEQYTETIT

14-020/04-196171/22 më 22. 09. 2023

Në bazë të dispozitave të nenit 13 dhe 58 të Ligjit nr. 03/L - 040, për vetëqeverisje lokale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës", nr. 28/15 qershor 2008), nenit 9 të Rregullores për ndarjen e subvencioneve nga Komuna e Prishtinës 01-020/01-194101/18 e dt. 08/08.2018 dhe të nenit 53 të Statutit të Komunës së Prishtinës, 01. nr.110 - 391, të dt. 25.02.2010, Kryetari i Kryeqytetit, merr këtë:

V E N D I M

1. Miratohet Vendimi për caktimin e Komisionit për shqyrtimin e ankesave për subvencionim në raste të veçanta, në bazë të kërkesës së arsyetuar si dhe ankesat për shpenzimet e funeralit.
2. Sipas pikës 1 të këtij Vendimi, anëtarë të Komisionit janë:
 1. Afërdita Krasniqi, Drejtorja e Administratës;
 2. Linda Spahiu, Drejtorja e Administratës;
 3. Vjollca Rexhepi, Sektori Ligjor.
3. Detyrë e Komisionit të cekur si në pikën 2 të këtij Vendimi, është shqyrtimi dhe vendosja e ankesave për subvencionim në raste të veçanta, në bazë të kërkesës së arsyetuar si dhe ankesat për shpenzimet e funeralit, bazuar në Rregulloren për ndarjen e subvencioneve nga Komuna e Prishtinës.
4. Për kryerjen e detyrave të cekura si në pikën 3 të këtij Vendimi, Komisioni i raporton Kryetarit të Kryeqytetit.
5. Ky vendim hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit të tij.

U dorëzohet

- Anëtarëve,
- Qendrës për komunikim me qytetarë,
- Në dosje.

KRYETARI I KRYEQYTETIT

Përparim Rama

